

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6780
E hënë, 12 dhjetor 2022
çmimi 0.40

Në planin franko-gjerman nuk përmendet njohja e ndërsjellë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI | FAQE 4-5-6

RIPËRCAKTIMI I KUFIJVE PËRMBYLL KAPITULLIN E KONFLIKTIT SHQIPTARO-SERB NË BALLKAN

- Veriu është barrë e rëndë për Kosovën, qasja e kryeministrit Kurti, e gabuar

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka thënë se veriu vazhdon të jetë një barrë e rëndë për Kosovën. Ai theksuar se politika jo vetëm që e ka injoruar veriun, por e ka drejtuar debatin për zgjidhjen e problemit të tij në funksion të luftës së brendshme politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka theksuar se qasja e deritashme e kryeministrit Kurti nuk ka zgjidhur asgjë në veriun e vendit. Ndërsa duke folur për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Murati ka thënë se themelimi i tij do të shndërrohej në një gur të rëndë mbi shpinën e shtetit të brishtë të Kosovës. Lideri i LB-së ka thënë se ripërcaktimi i kufijve do ta shënonte përmbylljen e kapitullit të konfliktit shqiptaro-serb në Ballkan



RRUGËT NË VERIUN E KOSOVËS MBETEN TË BLOKUARA

SHBA-JA DHE BE-ja BËJNË THIRRJE PËR ÇMONTIMIN E BARRIKADAVE NË VERI



Policia e Kosovës dhe Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit (EULEX) raportuan të dielën për incidente në veriun e vendit ku rrugët kryesore po mbahen të bllokuara nga qytetarë serbë. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë dhe Bashkimi Evropian shprehën shqetësim të thellë për situatën aktuale në veri të Kosovës dhe bënë thirrje për çmontimin e menjëhershëm të barrikadave të ngritura

AKTUALE



VAZHDOJNË LUFTIME INTENSIVE NË PJESËN LINDORE TË UKRAINËS F. 2

SHQIPËRI, MOTI I KEQ SHKAKTON PËRMBYTJE DHE BLOKIM RRUGËSH F. 2



EKONOMI



BQK-ja: VLERA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË KA SHËNUAR RRIJTJE F. 8

LIGJI PËR PAGA DO TË HYJË NË FUQI NË TREMUJORIN E PARË TË 2023-s F. 8

SPORT



PRISHTINA E FITON SUPERKUPËN, FINALJA U PËRSHKRUA ME INCIDENTE TË RËNDA F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vazhdojnë luftime intensive në pjesën lindore të Ukrainës

KIEV, 11 DHJETOR - Pjesa lindore e Ukrainës është goditur nga sulme prej të dyja anëve të luftës - Rusia që lëshonte dronë drejt Odesas dhe Kievi që i kthente përgjigje në Melitopol.

Ushtria ukrainase tha se i rrëzoi dhjetë dronë të lëshuar nga Rusia të shtunën, por pesë dronë të tjerë arritën ta godasin infrastrukturën energjetike, duke i lënë kështu rreth 1.5 milion banorë pa rrymë.

Më vonë, kryetari i internuar i Melitopolit tha se ishte kryer një sulm në qytetin që aktualisht kontrollohet nga forcat ruse.

Pamjet e publikuara nga një zyrtar i emëruar nga Rusia aty tregojnë se kishte pasur një zjarr të madh.

Sulmet me dronë të Rusisë në Odesa u kryen përmes dronëve të

prodhuar nga Irani dhe ata kishin cak pikat kyçe infrastrukturore të Ukrainës, tha një zyrtar ukrainas. "Situata në rajonin e Odesas është shumë e vështirë", tha presidenti Volodymyr Zelensky në adresimin e tij të përnatshëm. "Fatkeqësisht, goditjet ishin kritike, kështu që do të na duhet më shumë sesa vetëm kohë për ta restauruar elektricitetin. Nuk do të na duhen orë, por disa ditë".

Që nga tetori Moska ka sulmuar pika kyçe të infrastrukturës energjetike të Ukrainës me sulme të shumta me predha dhe dronë. Në Melitopol autoritetet pro-ruse thanë se një sulm me predha i kishte lënë të vdekur dy persona, ndërsa të lënduar dhjetë të tjerë. Ndërsa Ivan Fedorov, kryetari i internuar, tha se disa "pushtues" ishin vrarë. "Sistemet e mbrojtjes



ajrore shkatërruan dy raketa, katër [raketa] arritën objektivat e tyre", tha Yevgeny Balitsky, guvernatori i emëruar nga Moska

për pjesën e pushtuar të rajonit të Zaporizhjas, në aplikacionin e mesazheve "Telegram". Ai shtoi se një sulm ukrainas me

raketa Himars e kishte shkatërruar një "qendër rekreacioni" ku njerëzit po hanin darkë.

Gjermania merr masa për ta forcuar Ligjin mbi Armët pas dyshimeve për përpjekje për grushtshtet

BERLIN, 11 DHJETOR - Ministrja e Brendshme e Gjermanisë, Nancy Faeser, njoftoi se vendi i saj po planifikon ta forcojë Ligjin mbi Armët pas përpjekjeve të dyshuara nga një grup i ekstremit të djathtë për të rrëzuar me dhunë qeverinë e për të vendosur në krye të vendit një pasardhës të një familje mbretërore. Faeser i bëri komentet për gazetën "Bildam Sonntag", në një intervistë botuar të dielën.

Javën e kaluar policia gjermane arrestoi 25 persona që dyshohet



se ishin përfshirë në këtë komplot, i cili ka tronditur shumë njerëz në një nga

demokracitë më të qëndrueshme të Evropës. Sipas prokurorëve, shumë nga të

dyshuarit ishin anëtarë të lëvizjes së ekstremit të djathtë "Reichsbuerger" (Qytetarët e Rajhut), i cili mohon ekzistencën e shtetit modern gjerman. Ministrja e Brendshme tha se "Reichsbuerger" përfaqëson një kërcënim në rritje për Gjermaninë duke qenë se vitin e kaluar lëvizja ishte zgjeruar nga 2 000 në 23 000 anëtarë. "Këta nuk janë njerëz të çmendur e të padëmshëm, por terroristë të dyshuar që tashmë ndodhen në paraburgim", tha ajo për gazetën "Bildam Sonntag".

Prokurorët thanë se mes të dyshuarve kishte persona të armatosur e me njohuri për përdorimin e armëve të zjarrit. Ata kishin tentuar të rekrutonin pjesëtarë aktualë të ushtrisë apo dhe ish-ushtarakë si dhe kishin grumbulluar armë.

Përpara bastisjeve, autoritetet kishin konfiskuar armë nga më shumë se 1 000 anëtarë të lëvizjes. Besohet se të paktën 500 persona të tjerë disponojnë leje për armë zjarri, në një vend ku posedimi i tyre nga persona privatë është i rrallë.

Moti i keq shkakton përmbytje dhe bllokim rrugësh në Shqipëri

TIANË, 11 DHJETOR - Reshje të dendura shiu kanë përfshirë gjatë vikendit pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë duke shkakuar probleme në disa prej qarqeve të vendit. Sipas të dhënave të fundit nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, në disa zona ka dalje të lumenjve nga shtretërit, përmbytje të tokave bujqësore, banesa me prani të ujit si dhe ndërprerje të energjisë elektrike.

Në lagjen "Sanxhak" të qytetit të Laçit 15 banesa gjenden të rrethuara nga uji, ndërsa në Lezhë dhe Shkodër më shumë se 500 hektarë tokë bujqësore janë përmbytur. Për shkak të motit të keq, në shumë prej fshatrave të vendit ka pasur ndërprerje të energjisë elektrike.

Në Mirditë, përroi i Zmejës, në afërsi të qytetit Rrëshen, ka arritur

në kuotën kritike, duke rrezikuar gjithë zonën. Për shkak të prurjeve të shumta nga reshjet, në Rrëshen është hapur diga e rezervuarit të Qafmollës, ndërsa në Krujë lumi Ishëm ka dalë nga shtrati në pjesën e fshatit Marqinë, njësi administrative Bubq.

Po ashtu, në Shijak lumi Erzen ka dalë nga shtrati në pjesën e fshatit Hardhishtë, njësi administrative Gjepalaj, ndërsa në lagjen "Granicë" të qytetit të Gjirokastrës përroi i "Çullos" ka shtuar prurjet dhe rrezikon banesat, ndërkohë që është bllokuar lagja Lenxat në fshatin Lazarat.

Në aksin rrugor Kardhiq - Delvinë, 200 metra pranë tunelit të Skërficës, kanë vërshuar ujërat e një përroi malor, ndërsa në aksin e Rrugës së Arbërit, që shkon drejt Dibrës, sipër tuneleve në drejtim të Qafë-Murrizës, ka rrëshqitje të



dherave nga skarpitet në një segment rruge, duke e bërë rrugën të pakalueshme.

Edhe në aksin rrugor Burrel - Shkopet ka rënie gurësh në dy segmente. Rënie të inerteve ka edhe në rrugën që shkon në fshatrat Bënçë e Lekdush, në aksin

Elbasan - Qafë-Thanë, Elbasan - Gjinar, Gramsh - Moglice.

Thuhet se çdo vit territori i Shqipërisë përballet me situata emergjence për shkak të reshjeve të shiut dhe dëborës, që shkaktojnë dëme të konsiderueshme në mjedis, bujqësi, infrastrukturën rrugore,

por edhe në jetën e përditshme të mijëra familjeve. Sipas ekspertëve, kjo situatë krijohet për shkak të ndërhyrjeve njerëzore pa kriter në mjedis, ndërtimeve të pakontrolluara përgjatë viteve, dëmtimit të sipërfaqeve pyjore dhe sistemit të kanalizimeve.

RRUGËT NË VERIUN E KOSOVËS MBETEN TË BLOKUARA

ShBA-ja dhe BE-ja bëjnë thirrje për çmontimin e barrikadave në veri

Policia e Kosovës dhe Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit (EULEX) raportuan të dielën për incidente në veriun e vendit. Rrugët kryesore në këtë pjesë po mbahen të bllokuara nga grupe qytetarë serbë. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë dhe Bashkimi Evropian shprehën shqetësim të thellë për situatën aktuale në veri të Kosovës dhe bënë thirrje për çmontimin e menjëhershëm të barrikadave të ngritura

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara shprehën shqetësim të thellë për situatën aktuale në veri të Kosovës dhe bënë thirrje për çmontimin e menjëhershëm të barrikadave të ngritura.

Nga e shtuna pasdite disa serbë lokalë ngritën barrikada në komunat Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok në veri të Kosovës dhe bllokuan disa rrugë. Ata ndërmorën këtë veprim pasi Policia e Kosovës arrestoi ish-zyrtarin serb të këtij institucioni, Dejan Pantiq, nën dyshimet se ka organizuar "sulm terrorist" në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shtyrë zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri për 23 prill të vitit 2023, të cilat ishin paraparë të mbahen më 18 dhjetor të këtij viti.

Në një deklaratë të përbashkët për medie, ambasada e ShBA-së në Prishtinë dhe Beograd thanë se "ky arrestim po përdoret si justifikim për bllokime të paligjshme të rrugëve si dhe për kërcënime dhe frikësime të autoriteteve kosovare dhe popullatës lokale". "U bëjmë thirrje të gjithëve që të ushtrojnë përmbytje maksimale, të marrin masa të menjëhershme për ta shtensionuar situatën dhe të përmbahen nga aktet

provokuese. Ne i nxisim palët që të punojnë në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja për t'i zgjidhur çështjet përkatëse", thuhet në deklaratën e lëshuar të dielën pasdite.

Aty, po ashtu, shprehet mbështetje për misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, dhe për misionin evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka kërkuar që barrikadat e ngritura në veri të Kosovës të largohen menjëherë "nga grupet e serbëve të Kosovës". "Barrikadat duhet të largohen menjëherë nga grupet e serbëve të Kosovës. Qetësia duhet të restaurohet", ka shkruar Borrell në "Twitter".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Kosova po punon me KFOR-in për ta adresuar situatën "shpejt dhe në mënyrë paqësore", por ka cilësuar se për tensionimet e fundit në veri nuk ka "pretekst". "Bllokimi i rrugëve publike me automjete të rënda për ta penguar lirinë e lëvizjes nga bandat kriminale që qëllojnë mbi policinë tonë e mbi policinë e EULEX-it jo vetëm që është e papranueshëm, por duhet të jetë edhe i papërsëritshëm kurdoherë në të ardhmen. Andaj ne po presim. KFOR-i po kërkon pak kohë që shpejt ta kryejë këtë



punë dhe ne po presim. Nëse prita jonë për KFOR-in është zbutje le të quhet zbutje, por për të mirën e përgjithshme besoj se, megjithatë, jemi duke zgjedhur rrugën më të mirë të mundshme", tha kryeministri Kurti.

Gjithashtu, Kurti u është kundërpërgjigjur kërkesave të presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, dhe kryeministres serbe, Ana Bërnabiq, për dislokimin e pjesëtarëve të ushtrisë dhe policisë serbe në territorin e Kosovës, duke thënë se "Republika e Kosovës do të mbrohet - me forcë dhe vendosmëri". "Presidentja dhe kryeministri i Serbisë kanë kërcënuar edhe me agresion ushtarak, duke kërkuar që ushtria serbe të kthehet në territorin tonë. Ne nuk kërkojmë konflikt, por dialog dhe paqe. Por më lejoni të jem i qartë: Republika e Kosovës do të mbrohet - me forcë dhe vendosmëri", ka deklaruar Kurti.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se mesazhi i tij për serbët nga Kosova është se "nuk ka dorëzim dhe nuk do të ketë

dorëzim". Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se mbrëmjen e 10 dhjetorit janë ngritur gjashtë barrikada në Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Ai tha se pikëkalimet kufitare Jarinje dhe Bërnjak janë ende të mbyllura për arsye sigurie.

Sveçla u bëri thirrje serbëve lokalë t'i largojnë barrikadat në veri, ndërsa shtoi se nëse barrikadat nuk hiqen, atëherë do të merren veprimet e duhura, por pa dhënë detaje se për çfarë veprimesh bëhet fjalë. "Bëra apel që këto barrikada të tërhiqen. Patjetër që Policia e Kosovës i ka kapacitetet e duhura të veprimit në këtë drejtim. Ajo i bën planet e saj operative dhe në momentin që e vlerëson të duhur, nëse barrikadat nuk tërhiqen, do t'i ndërmarë veprimet e duhura", tha Sveçla.

Ai tha se janë në koordinim me partnerët ndërkombëtarë dhe se "shumë shpejt do të mbërrijmë në situatën kur nuk do të ketë më barrikada në veri". Sipas tij, barrikadat janë vendosur me arsyen, siç tha ai, të pengohet dërgimi i Pantiqit

në jug pas caktimit të masës së ndalimit prej 48-orësh.

Policia e Kosovës dhe Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit (EULEX) raportuan të dielën për incidente në veriun e vendit ku rrugët kryesore po mbahen të bllokuara nga qytetarë serbë. EULEX-i ka njoftuar se "një bombë tronditëse u hodh kundër një patrulle të këtij misioni", por pa dëme në njerëz. "Ky sulm, si dhe sulmet ndaj zyrtarëve të Policisë së Kosovës, janë të papranueshme. Ne i dënojmë fuqishëm aktet e dhunshme të kryera nga persona të armatosur në pjesën veriore të Kosovës, përfshirë ato kundër komunitetit ndërkombëtar", thuhet në njoftimin e EULEX-it, në të cilin nënvizohet gatishmëria për ta ruajtur qëndrueshmërinë dhe sigurinë e qytetarëve. "U bëjmë thirrje të gjithë atyre që janë përgjegjës, të përmbahen nga veprime të tjera provokuese si dhe u bëjmë thirrje institucioneve të Kosovës që autorët t'i sjellin përpara drejtësisë", thuhet në njoftimin e EULEX-it.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, VALON MURATI

Ripërcaktimi i kufijve përmbyll kapitullin e konfliktit shqiptaro-serb në Ballkan

- Veriu është barrë e rëndë për Kosovën, qasja e kryeministrit Kurti, e gabuar

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 11 DHJETOR-

“Epoka e re”: Z. Murati si jeni duke i parë zhvillimet e përgjithshme në Kosovë, sidomos ato në raport me dialogun me Serbinë, duke përfshirë veriu?

Murati: Duan apo nuk duan kryeministrat tanë, qeveritë dhe partitë politike, çështja e marrëdhënieve me Serbinë do ta përcaktojë fatin e çdo qeverie deri në zgjidhjen e këtyre marrëdhënieve, për faktin se dialogu dhe rezultatet e tij lidhen edhe me sigurinë rajonale e cila në dritën e agresionit rus në Ukrainë merr peshë edhe më të madhe. Situata kohën e fundit, duke filluar nga “kriza e targave” deri te kriza e këtyre ditëve, që po manifestohet me incidente të përnatshme në veri, e që fillimisht lidhej me zgjedhjet lokale në veriun e vendit si

pasojë e largimit nga institucionet e përfaqësuesve serbë, e dëshmon këtë. Tani ndonëse kemi shtyrje të zgjedhjeve, veriu vazhdon të jetë i tensionuar dhe i bllokuar për shkak të arrestimit të një ish-polici serb, i cili ka qenë i përfshirë në sulmin ndaj zyrave të KQZ-së dhe policisë në veri. Ky bllokim në të vërtetë është një reaktion dhe mesazh politik për të dëshmuar se Kosova e ka vështirë të vendosë rend dhe ligj në atë pjesë të vendit. Veriu i vendit është një barrë e madhe për Kosovën, të cilën politika jonë jo vetëm që e ka injoruar, por e ka drejtuar debatin për zgjidhjen e problemit të tij në funksion të luftës së brendshme politike dhe si mjet elektoral. Sigurisht krejt kjo situatë lidhet me dialogun, me presionin ndërkombëtar, me faktin se të dyja palët për arsye të ndryshme nuk janë entuziaste me atë që po quhet plani franko-gjerman.

Ndonëse është i rëndësishëm pozicioni dhe qasja e Serbisë, se me të duhet të merremi vesh, në radhë të parë duhet të brengosemi për pozicionin dhe hapat që po i merr qeveria jonë. Për mendimin tim, politika populiste e kryeministrit Kurti nuk identifikohet askund më shumë se me qasjen që ka ai ndaj dialogut me Serbinë. Rrjedhimisht qasja e tij e deritanishme nuk ka zgjidhur asgjë në veriun e vendit, por vetëm ka tensionuar situatën dhe e ka shpërfaqur të vërtetën lakuriq mbi veriun e vendit për të cilin qeveritë tona kanë pas krijuar iluzione te qytetarët dhe opinioni publik se e kanë shtrirë sovranitetin.

“Epoka e re”: Po punën e qeverisë Kurti?

Murati: Realisht ne më shumë duhet të kemi vërejtje për mospunën e qeverisë Kurti sesa vërejtje për punët që po i bën.

Përkundër një opozite të gjatë, qeveria Kurti, e cila ka ardhur në pushtet duke kritikuar ashpër qeveritë e kaluara, nuk është duke dëshmuar se ka ndonjë vizion të qartë mbi drejtimin që do t'i japë vendit në fushën e ekonomisë, arsimit, shëndetësisë e madje as të sundimit të ligjit. Përderisa nuk vërehet ndonjë vizion, nuk mund të flasim pastaj për politikat konkrete. Si shumë qeveri të kaluara, kemi veprime ad hoc, për më tepër kjo qeveri është një qeveri e reaksionit, e jo një qeveri e aksionit. Edhe në këtë qasjen e reagimit, krijimi i konflikteve dhe shpallja e armiqve nga e gjithë shoqëria, duke u nisur nga sindikatat, për të vazhduar te bizneset e mediet, e për të përfunduar te gjyqësia dhe prokuroria mbetet një tipar i mendësisë qeverisëse të kryeministrit Kurti, mendësi që e ka mbjellë gjerësisht edhe sa ka qenë në opozitë. E, mbi të

gjitha, deri më tani, kjo qeveri, me tërë këtë legjitimitet, në vend se të jetë qeveri e projekteve të mëdha, ajo është qeveri e bllokadave të mëdha. Nën një frikë të supozuar nga mundësia e korrupsionit, kemi bllokim të shumë projekteve dhe një qasje jo të duhur ndaj nismave për investime. Të shpresojmë se kjo logjikë qeverisëse do të ndryshojë në mënyrë që të hapet debati për projektet konkrete e jo për mungesën e tyre.

Shumë më e rëndësishme sesa zgjidhja e problemit të targave është zgjidhja politike e problemit të veriut

“Epoka e re”: Çfarë vlerësimi keni për “betejën” që Kurti kishte bërë për targat ilegale serbe?

Murati: Është në natyrën e politikanëve populistë, dhe

politikave populiste, që të dizajnojnë politika të cilat në dukje janë parimore, të fitojë kështu simpatinë e publikut dhe elektoratit, por të cilat shtyhen përpara për të krijuar tensione dhe për të mos zgjidhur probleme. E tillë është edhe çështja e targave serbe në Kosovë. Ajo në pamje të parë është një çështje e sundimit të ligjit, dhe Kosova është në të drejtën e saj që ta shtrijë sundimin e ligjit në tërë territorin e saj. Por, në anën tjetër, Kosova, po ashtu, është në një proces negociator. Dhe, mbi të gjitha, ai proces po zhvillohet për shkak të veriut të vendit dhe vështirësive që Kosova ka pasur prej vitit 1999, me theks të posaçëm nga viti 2008 që ta shtrijë sovranitetin atje. Andaj shumë më e rëndësishme sesa zgjidhja e problemit të targave, është zgjidhja politike e problemit të veriut, në kuadër të së cilës pastaj çështja e targave do zgjidhet lehtësisht. Mbi të gjitha, është gabim i jashtëzakonshëm që me Serbinë të negociohet për çështjet e brendshme të Kosovës. Nëse nuk ka mundësi të implementimit të targave të Kosovës apo të ndonjë projekti tjetër, më mirë është të shtyhet deri në një moment të duhur sesa të dialogohet me Serbinë. Në këtë mënyrë nuk ishin tensionuar marrëdhëniet me aleatët tanë e as nuk do të bëhej Serbia palë në kompromiset që shteti ynë bën për një çështje të sovranitetit të brendshëm.

“Epoka e re”: *Bashkësia ndërkombëtare po insiston që Kosova ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. A do të mund t'i bëjë ballë këtij presioni kryeministri Kurti?*

Murati: Çfarëdo përgjigje në këtë pyetje është hipotetike. Sidoqoftë, duke u nisur nga diskursi politik mbi të cilin e ka ndërtuar identitetin e tij politik, fatkeqësisht gjithmonë në funksion të votave dhe luftës për pushtet, e jo zgjidhjes së problemeve, unë konsideroj se kryeministri Kurti nuk do ta zbatojë asociacionin, e sidomos jo nëse ai vjen si parakusht për planin franko-gjerman dhe pa njohjen zyrtare nga ana e Serbisë. Dhe deri këtu, për mendimin tim, është në rregull. Problemi fillon kur ky refuzim përcillet me mungesën e opsioneve alternative nga ana e palës sonë. Mungesa e këtyre alternativave e vendos qeverinë tonë në pozicion të vështirë negociues. Unë nuk jam prej atyre që mendojnë se do të ndodhte apokalipsi në rast të refuzimit të zbatimit të asociacionit, edhe pse Kosova e ka pranuar atë me marrëveshjen e vitit 2013 dhe e ka ligj të brendshëm. Por, në anën tjetër, Kosova, me këtë qasje në bisedime, e nisur që nga viti 2011, ka humbur shumë kohë në zgjidhjen e problemeve që ka me Serbinë dhe, rrjedhimisht, ka humbur kohë me konsolidimin dhe funksionalizimin e brendshëm.

Kosova dhe elita politike nuk do të duhej t'i shihte bisedimet me Serbinë si kusht i vendosur nga ndërkombëtarët, por si mundësi për t'i zgjidhur problemet e mbetura me Serbinë. Kur do të shihej kështu dialogu, atëherë qasja jonë do të ishte shumë më aktive, do të kishim më shumë alternativa dhe nuk do të vendosnim vija të kuqe bllokuese në bisedime, por do ta përdornim imagjinatën në funksion të vizionit politik që do të ofronte zgjidhje funksionale përmes platformave politike të ndërtuara me kujdes dhe konsensus.

“Epoka e re”: *Çfarë do të ndodhte me vendin nëse Kurti do ta pranonte Asociacionin të cilin e kishte kundërshtuar fuqishëm?*

Murati: Në radhë të parë, zbatimi i Asociacionit, edhe nëse do të vinte me një avancim në subjektivitetin e jashtëm, do të thoshte dobësim i funksionalitetit të brendshëm të Kosovës. Kosova edhe ashtu vuan nga jonfunksionaliteti i brendshëm që buron nga Kushtetuta e vet e që rrjedh nga Pakoja e Ahtisaarit për shkak të garantimit të privilegjeve për pakicën serbe, e sidomos mundësisë që përfaqësuesit politikë serbë (nën ndikimin e Serbisë, por me mundësi edhe të Moskës) kanë për t'i bllokuar ndryshimet kushtetuese dhe miratimin e disa prej ligjeve në fushat që konsiderohen vitale. Tash nëse këtij rregullimi ia

shtojmë edhe një mekanizëm si Asociacioni, qoftë me përgjegjësi e qoftë pa ato ekzekutive, ne futemi në një cikël të ri jofunksionaliteti. Asociacioni që do t'i grumbullonte komunat serbe si një mekanizëm institucional që ka kryetar, qeveri e asamble, kur të kombinohet bashkë me privilegjet kushtetuese që serbët i kanë të garantuara nga Kushtetuta e Kosovës, shndërrohet në një gur të rëndë mbi shpinën e shtetit të brishtë të Kosovës, duke e rënduar funksionalitetin e përditshëm të republikës sonë. Me këtë zgjidhje, problemet nuk mbarojnë, vetëm barten në një nivel tjetër. Tanimë Kosovës do t'i duhet të merret tërë kohën me obstrukcionet që do t'i vinin nga asociacioni, sigurisht në këto rrethana të nxitura edhe nga Beogradi zyrtar, duke vënë në pikëpyetje edhe të arriturat e subjektivitetit të jashtëm. Për më tepër në rrethanat e reja gjeopolitike, Rusia, po ashtu, do të mund të shfrytëzonte një mekanizëm të tillë për ta destabilizuar Kosovën dhe rajonin. Sado i rëndësishëm që është për një shtet dhe sovranitetin e tij pjesa e jashtme e këtij sovraniteti, unë do ta kisha vendosur prioritet në zgjidhjen e problemeve me Serbinë sovranitetin e brendshëm. Ka shtete që janë edhe pjesë e OKB-së, por kanë probleme thelbësore me sovranitetin dhe funksionalitetin e brendshëm. Mos të shkojmë hiç më larg se

në rajonin tonë dhe ta marrim shembull Bosnjë-Hercegovinën. Andaj mendoj se qasja e qeverive tona, e sublimuar me sloganin e kryeministrit Kurit, se 'bisedimet me Serbinë duhet ta kenë në qendër njohjen', ka qenë e gabuar. Për më tepër siç po shihet nga ajo që ka dalë në opinion nga plani franko-gjerman fare nuk do të ketë njohje me këtë plan. Qasja e vetme e drejtë në këto bisedime është dashur të jetë dhe duhet të jetë reciprociteti në qendër: çfarëdo zgjidhje që gjendet për veriun e vendit të ofrohet për Kosovën Lindore.

Njëherë nuk po duket se ka gjasa që të kemi zgjedhje

“Epoka e re”: *A mund ta dërgojë vendin në zgjedhje refuzimi i Asociacionit?*

Murati: Nuk mendoj që si i vetëm, refuzimi i zbatimit të Asociacionit do ta dërgonte vendin në zgjedhje përderisa dështimi i arritjes së një marrëveshjeje me Serbinë edhe mund të krijojë rrethana për zgjedhje të reja. Ai që mund ta dërgojë vendin në zgjedhje për shkak të presionit për Asociacionin është vetëm kryeministri Kurti. Sidoqoftë, njëherë përnjëherë nuk po duket se ka gjasa që të kemi zgjedhje së shpejti. Në parim ne kemi një qeveri me një legjitimitet të madh popullor, me mundësi që ky legjitimitet të





shfrytëzohet për t'i zgjidhur problemet më të mprehta me Serbinë dhe nuk është në interesin e Kosovës që vendi të shkojë në zgjedhje. Por këto rrethana mund të ndryshojnë dhe varen jo vetëm nga zhvillimet e brendshme dhe faktorët e brendshëm politikë, por edhe ndikimi që mund të kenë faktorët e jashtëm në proceset e brendshme e sidomos sa i përket dinamikës dhe rezultateve të dialogut me Serbinë.

“Epoka e re”: Kur jemi te marrëveshjet Kosovë - Serbi, çfarë vlerësimi keni për planin franko-gjerman?

Murati: Siç theksova më herët, ky plan (për aq sa ka dalë në opinion dhe komentuar jo zyrtarisht), i cili nuk është një plan përfundimtar, ka bërë përpjekje t'i balancojë interesat e të dyja palëve. Në planin e sovranitetit të jashtëm Kosovës i hapet rruga për njohjen nga ana e pesë shteteve anëtare të BE-së, anëtarësimi në Këshillin e Evropës, hapja e rrugës për anëtarësim në NATO etj. Serbisë nuk i kërkohet të njohë shtetin e Kosovës, por në një mënyrë i kërkohet ta njohë gjendjen faktike juridike. Në këtë drejtim, ky plan është më i favorshëm për Kosovën. Sidoqoftë, ky plan duket se përmban edhe pjesën që obligon Kosovën ta zbatojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë drejtim ky Asociacion e godet sovranitetin e brendshëm të Kosovës, rrjedhimisht funksionalitetin e saj. Po ashtu, duke qenë se plani nuk është përfundimtar dhe nuk i kërkohet Serbisë njohje eksplicite në këtë fazë, i jep planit një përkohshmëri, duke synuar t'i balancojë interesat e Serbisë. Për shkak të këtij konteksti të komplikuar dhe kompleks, personalisht nuk

besoj se plani do të pranohet nga të dyja palët. Ndonëse për aq sa po mund të përvijohet nga qëndrimet qoftë të qeverisë sonë, qoftë të presidentit Vuçiq, ka një tendencë që refuzimi fillestar t'i atribuohet palës tjetër në mënyrë që kështu të përfitohet ndonjë simpati në raport me ndërkombëtarët.

Si zgjidhje përfundimtare, ripërcaktimi i kufijve

“Epoka e re”: Z. Murati, jeni nga të pakët politikanë që jeni duke insistuar në idenë e korigjimit të kufijve. Mund të na zbërtheni si mund të duket korigjimi i kufijve?

Murati: Në radhë të parë Kosova duhet t'i ikë një gracke në të cilën është futur që nga viti 2011, që në bisedimet me Serbinë të flitet për çështjet e brendshme të Kosovës. Ka ndodhur një përjashtim i shkurtër në këtë qasje, atëherë kur në vitin 2018, si rezultat i një konteksti ndërkombëtar të favorshëm, u hap për bisedime çështja e korigjimit të kufijve dhe kur ish-presidenti Thaçi theksoi se pjesë e këtij korigjimi duhet të jetë edhe Kosova Lindore. Përndryshe, as kjo qeveri që ka ardhur me aq bujë kundër këtij formati të bisedimeve nuk ka dalë nga kjo grackë, përkundrazi është futur edhe më thellë në të, duke vazhduar dhe zbatuar marrëveshje që kanë të bëjnë me çështje të brendshme të Kosovës (si energjia, letërnjoftimet, targat etj.). Kosova dhe Serbia kanë probleme të pazgjidhura dhe ato janë pozita e serbëve në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan në njërin anë dhe pozita e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. Këto probleme duhet të zgjidhen duke zbatuar

parimin e reciprocitetit. Çfarëdo zgjidhje që do të vlejë për veriun e Kosovës duhet të vlejë edhe për Kosovën Lindore. Në situatën në të cilën është Kosova, nën presionin për ta zbatuar asociacionin dhe për t'u bërë pjesë e një marrëveshjeje që nuk është zgjidhje e problemeve me Serbinë, qasja më e duhur dhe më e drejtë është që në tavolinën e bisedimeve të shtrohet për zgjidhje edhe çështja e Kosovës Lindore dhe e shqiptarëve që jetojnë atje duke u bazuar në parimin e reciprocitetit. Në këtë drejtim, nëse i njëjti Asociacion përcjell me ndryshime kushtetuese në Serbi, ku shqiptarëve do t'u garantoheshin të njëjtat zgjidhje kushtetuese si për serbët në Kosovë, atëherë edhe zbatimi i asociacionit në Kosovë do të mund të ishte opsion. Nuk ka dyshim se një qasje e tillë logjikhëm do ta hapte mundësinë që duke mos u futur në aranzhmane të tilla të komplikuar kushtetuese, juridike dhe politike, ta zgjidhnim problemin në mes të Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht çështjen shqiptaro-serbe përmes ripërcaktimit të kufijve duke u bazuar në vetëvendosjen e popujve të atyre pjesëve. Andaj si zgjidhje përfundimtare, e cila Kosovën jo vetëm se do ta funksionalizonte në planin e brendshëm dhe atë të jashtëm, por do të hapte rrugën edhe për bashkimin në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, është ripërcaktimi i kufijve: pjesa ku shqiptarët janë shumicë dhe kanë vazhdimësi territoriale në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje të bashkohen me Kosovën, pjesa ku serbët janë shumicë dhe kanë vazhdimësi territoriale në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan të bashkohen me Serbinë.

“Epoka e re”: A besoni se korigjimi i kufijve do t'u jepte fund mosmarrëveshjeve Kosovë - Serbi dhe, rrjedhimisht, edhe Asociacionit?

Murati: Ripërcaktimi i kufijve do ta shënonte përmbylljen e kapitullit të konfliktit shqiptaro-serb në Ballkan dhe besoj se do ta shënonte fillimin e një epoke të re në këto marrëdhënie e në kuadër të tyre edhe të Kosovës me Serbinë. Sigurisht shekujt e armiqësive, pushtimit dhe luftërave nuk do të mund shpejt e shpejt të harroheshin, por e rëndësishme është se do të krijoheshin kushtet që bazat e marrëdhënieve të reja të vendoseshin. Mbi të gjitha, pas ripërcaktimit të kufijve do të krijoheshin rrethanat që Kosova ta ndryshonte Kushtetutën e vet dhe t'i hiqte pengesat kushtetuese për bashkim me Republikën e Shqipërisë. Kështu do të krijoheshin rrethanat që të ndërtoheshin raporte të tjera me Shqipërinë dhe do të hapet rruga për krijimin e një shteti të përbashkët, nëse për këtë do të kishte vullnet të qytetarëve. Për të qenë krejtësisht i sinqertë, unë besoj thellë se në rast të heqjes së pengesave, dhe në një kontekst ndërkombëtar të favorshëm, vullneti për bashkim do të ishte absolut në të dy shtetet tona. Kjo do të ishte e tillë edhe kur të merren parasysh zhvillimet e fundit gjeopolitike, që një shtet i tillë do të ofronte një siguri më të madhe për qytetarët e saj, si dhe një ekonomi më komplementare e kompetitive. Ky shtet i përbashkët do të krijonte një situatë krejtësisht të re në Ballkan dhe do të ishte përgjigjja përfundimtare e synimeve serbe për kthim në Kosovë. Dhe kjo situatë, po ashtu, do të ndikonte që hapja e kapitullit të ri në marrëdhëniet shqiptaro-serbe

të ndodhë në rrethana krejt të tjera dhe shumë më të barabarta se në të kaluarën. Sidoqoftë, me apo pa bashkim, përmes kësaj zgjidhjeje, në përfundimisht do të futeshim në një epokë të re politike në Kosovë, ku qendra e debatit më nuk do të ishim marrëdhëniet me Serbinë dhe funksionaliteti i shtetit të Kosovës, por mirëqenia e qytetarëve, zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, arsimit e shëndetësia etj. Në një situatë të tillë do të kishim një ndryshim edhe të garniturës politike. Çdoherë e më pak do të kishte vend për politikanë e politika populiste dhe vendin e tyre do ta zinin politikanët racionalë me politika të përpunuara në fushat konkrete. Përndryshe me problemet e veriut dhe dialogun me Serbinë si tema të vazhdueshme, ne do të kemi në qafë edhe këta politikanë, që armët më të forta elektorale i kanë politikën populiste dhe raportet me Serbinë.

Politika e jashtme e kësaj qeverie është konfuze

“Epoka e re”: Z. Murati, çfarë vlerësimi keni për politikën e jashtme të Kosovës?

Murati: Politika e jashtme e shteteve të vogla si Kosova duhet të jetë shumë e kujdesshme, e balancuar, e fokusuar dhe e koordinuar me ata që i konsideron aleatë strategjikë. Përshtypja ime është që politika e jashtme e kësaj qeverie është konfuze dhe pa ndonjë busull të qartë. Ka një tension me aleatët kryesorë e sidomos me ShBA-në dhe BE-në e që lidhet kryesisht me qasjen rreth dialogut, dhe ka një izolim të pakuptueshëm në raport me shtetin shqiptar dhe mungesë të dukshme të koordinimit të politikës së jashtme në kohën e ngritjes së peshës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sigurisht, në raport me vijën strategjike, siç u dëshmuar me qëndrimin ndaj agresionit rus në Ukrainë, edhe kjo qeveri ka koordinuar politikën e saj me të aleatëve. Kohën e fundit vërehet një aktivizim në përpjekjet për anëtarësim në Këshillin e Evropës, ku është aplikuar në pranverën e këtij viti dhe ku gjasat janë reale për t'i anëtarësuar, përkundër mosprocedimit të deritanishëm të kërkesës sonë dhe kushtëzimit jopublik me rezultatet e dialogut. Po ashtu, pritet aplikimi për vend kandidat në BE, një hap që, ndonëse mund të konsiderohet se nuk do të japë rezultate konkrete, duket se qeveria po e bën si një lloj presioni politik mbi Bashkimin Evropian, por edhe si një veprim politik në funksion të politikës së brendshme.

Në planin franko-gjerman nuk përmendet njohja e ndërsjellë

Paprekshmëria e kufijve, njohja e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë janë disa nga elementet kyçe të të ashtuquajturit plan franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Të drejtat e barabarta Kosovës dhe Serbisë, respektim i integritetit territorial, paprekshmëri e kufijve, njohje e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë janë elementet kyçe të një propozimi të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Ky propozim, i njohur edhe si plani franko-gjerman, mësohet se u është dhënë palëve qysh në fund të verës.

Ai ka mbështetjen e Francës, Gjermanisë dhe Shteteve të Bashkuara.

Në dokumentin që siguroi REL nuk përmendet njohja e ndërsjellë mes Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, por theksohet mbështetja që palët duhet t'i japin njëra-tjetrës në procesin e integriteteve evropiane.

Nga Serbia, po ashtu, kërkohet që të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Disa burime në Bruksel dhe në kryeqytetet kryesore evropiane e konfirmuan vërtetësinë e propozimit.

Edhe pse gjatë periudhës së kaluar në medie u publikuan disa versione, aktorët kryesorë në Bruksel, Prishtinë apo Beograd, nuk e konfirmuan

asnjëherë autenticitetin e tyre, ndonëse pranuan se ekziston një plan.

Javën e kaluar, në margjinat e një samiti midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Tiranë, shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, konfirmoi se Kosova dhe Serbia kanë marrë versionin e përditësuar të planit.

Burimet e REL-it thonë se, edhe pse versioni i ri ka ndryshime, ato nuk janë thelbësore dhe se elementet kryesore për marrëveshjen bazë, mbeten të njëjta.

Propozimi i ka dhjetë pika dhe nëse palët pajtohen me të, ai do të hapë rrugën për vazhdimin e dialogut drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese.

Në dokument nënvizohet se nëse palët pajtohen me të, ato do të jenë të vetëdijshme se moscenimi i kufijve, respektimi i integritetit territorial dhe sovranitetit, si dhe mbrojtja e pakicave janë kushtet bazë për paqe.

Aty, po ashtu, nënvizohet se të dyja palët do të kenë si pikënisje qëllimin dhe parimet e vendosura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, posaçërisht respektimin e pavarësisë, autonomisë, integritetit territorial dhe të së drejtës për vetëvendosje, si dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut

dhe mosdiskriminimin.

Sipas propozimit, palët do të zhvillojnë marrëdhënie të mira fqinjësore mes vete, duke u bazuar në të drejtat e barabarta, si dhe do t'i njihin simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë pasaportat, targat e veturave, diplomat dhe vulat doganore. Të gjitha mospajtimet, sipas këtij propozimi, Kosova dhe Serbia do t'i zgjidhnin me mjete paqësore, duke u përmbajtur nga kërcënimet apo përdorimi i forcës.

Po sipas tij, palët do t'i hapnin "misionet e përhershme" në selitë qeveritare të njëra-tjetrës dhe do të niseshin nga fakti se "asnjëra nuk mund ta përfaqësojë palën tjetër në sferën ndërkombëtare".

Propozimi thekson në mënyrë eksplicite se "Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare".

Në një pikë të propozimit përmendet edhe rregullimi i statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si dhe aranzhimet për komunitetin serb në Kosovë.

Një nivel "i fortë" i mbrojtjes do të duhej t'i sigurohej Kishës Ortodokse Serbe dhe trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë, thuhet në propozim.

Ai nuk e përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë krijimin e

Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, por vë theksin mbi zbatimin e të gjitha obligimeve që kanë marrë palët, deri më tash, në dialogun e tyre për normalizimin e marrëdhënieve.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar asnjëherë.

Ndonëse autoritetet në Serbi insistojnë në zbatimin e saj, ato në Kosovë thonë se nuk mund të formojnë asociacion njëetnik.

Propozimi i BE-së thotë se, sa i përket "nivelit përkatës të vetëqeverisjes" për serbët e Kosovës, "të dyja palët obligohen që të vendosin aranzhime të posaçme dhe garanci në përputhje me instrumentet relevante të Këshillit të Evropës, duke u bazuar në përvojat ekzistuese evropiane". Kjo, me qëllim që të sigurohet niveli i duhur i vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë, si dhe kapacitetet për ofrimin e shërbimeve në disa fusha, përfshirë edhe mundësinë e mbështetjes financiare nga Serbia dhe kanalet e komunikimit direkt të komunitetit serb me Qeverinë e Kosovës.

Sipas dokumentit, palët do të duhej ta rrisnin bashkëpunimin në disa fusha, përfshirë:

shkencën, transportin, drejtësinë, postën dhe telekomun, shëndetësinë, kulturën, religjionin, sportin dhe mjedisin.

Dokumenti, në veçanti, përmend bashkëpunimin për çështjen e të pagjeturve nga lufta e viteve 1998/99 dhe të drejtat e personave të zhvendosur.

Palët, po ashtu, do të merrnin në konsideratë edhe përkushtimin e Bashkimit Evropian dhe të donatorëve tjerë për krijimin e një pakete të veçantë të mbështetjes financiare për projektet e përbashkëta.

Në fund, parashihet edhe krijimi i komisioneve të përbashkëta për të monitoruar zbatimin e vetë propozimit të BE-së.

Në fund, parashihet edhe krijimi i komisioneve të përbashkëta për të monitoruar zbatimin e vetë propozimit të BE-së.

Ato kanë arritur dhjetëra marrëveshje, por zbatimin e shumicës së tyre në terren ka ngecur.

Më herët zyrtarët në Prishtinë kanë thënë se propozimi i BE-së paraqet një bazë të mirë për ta vazhduar dialogun me Serbinë, ndërsa ata në Beograd kanë thënë se nuk është i favorshëm për ta.

BQK-ja: Vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë ka shënuar rritje

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Për dallim nga viti i kaluar, vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë ka shënuar rritje. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, nga 390 milionë euro sa ishin vitin e kaluar, këtë vit investimet e huaja kanë arritur shifrën mbi 560 milionë euro. Nga janari deri në muajin shtator 2022 vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë ka arritur në shumën prej 566.8 milionë eurosh. Kështu tha për "Radio Kosovën", përmes një përgjigjeje elektronike, zëdhënësi i BQK-së, Kushtrim Ahmeti. Ai bëri me dije se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar vlera e investimeve të huaja ishte 394.6 milionë euro. Drejtori i Këshillit i

Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, tha se gjendja është e mirë edhe përkundër luftës që po ndodh në Ukrainë, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në të bërit biznes. "Ajo çka është vërejtur gjatë kësaj periudhe është se ka pasur interesim të madh prej atyre kompanive që kanë operuar edhe në tregun rus apo të Ukrainës e të cilat në një formë kanë parë alternativë tërheqjen e domosdoshme dhe kanë kërkuar rajone stabile e që ofrojnë mundësi të reja. Unë jam vetë dëshmitar i asaj që kemi pritur disa prej kompanive që kanë shprehur interesim", tha Ujkani. Megjithatë ardhja e investitorëve merr kohë dhe kërkon procedura, Ujkani thekson se investimet e huaja



direkte kanë shënuar ngritje këtë vit: "Ne jemi duke përpunuar të dhënat tona dhe ende nuk i kemi finalizuar por, sido që të jetë, ka një rritje të mirë të

investimeve, marrë parasysh të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në glob", tha ai. Ujkani tha se është e rëndësishme edhe përkrahja e

institucioneve në këtë drejtim për t'u ofruar kushte atyre kompanive që duan të investojnë në Kosovë.

Ndërkaq, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, tha se duhet përkrahje institucionale që të ketë investime më kualitative në vend. "Vendi ka nevojë për investime kualitative që shtojnë prodhimin, rrisin punësimin dhe ngritin mirëqenien e qytetarit. Duhet të gjitha institucionet të jenë shumë agresive në mënyrë që të sjellin investitorë për të mirën e vendit tonë", tha ai.

Përkundër krizës globale që ka shkaktuar lufta në Ukrainë, Kosova ka shënuar ngritje të investimeve të huaja direkte, theksojnë ekspertët.

Tkurret forca e punës në Shqipëri

TIRANË, 11 DHJETOR - Bizneset në të gjithë sektorët pohojnë se mungesa e punonjësve është problem serioz për zgjidhjen e të cilit nuk kanë përvojë dhe as mjete. Ekonomia shqiptare kurrë më parë nuk është përballur me këtë fenomen. Qeveria e konsideron emigrimin si një fenomen normal dhe, nga ana tjetër, nuk i ka bërë më të lehta procedurat për sjelljen e punonjësve të huaj në mënyrë të organizuar. Disa biznese e kishin konsideruar si një mjet zëvendësues të punonjësve shqiptarë me të huaj, por procesi është i vështirë dhe me kosto dhe aktualisht nuk i plotësojnë nevojat e kohës. Një rrugë emigrimi me gomone drejt Britanisë këtë vit ka zbratur vendin me shpejtësi. Në dhjetëvjeçarin e fundit popullsia në moshë pune ka përfshirë rreth dy të tretat e së gjithë popullsisë së vendit. Në forcën e punës janë përfshirë 63.6 % të popullsisë në moshë pune, rreth 1.3 milion individë, ndërsa pjesa e mbetur përbën popullsinë



ekonomikisht joaktive. Në vitin 2015 për herë të parë që nga përfshirja e vendit tonë në ekonominë e tregut të lirë popullsia në moshë pune kapi shifrën 2 milionë. Viti 2018 shënoi frenimin e trendit rritës

prej mesatarisht 0.4 % në vit, që e karakterizoi këtë tregues nga viti 2009.

Rënia e popullsisë nën 34 vjeç po shënon edhe rënien totale të forcës së punës në vend. Sipas projeksioneve të reja të

popullsisë 2019-2031, për tri nënndarje të grupmoshës së të rinjve, për vitet 2018-2021, sipas të dhënave të mbledhura dhe projeksioneve të INSTAT, shihet qartë që prurjet e moshave 15-19 dhe 20-24 vjeç

paraqesin rënie të dukshme në vijim.

Në fillim të vitit 2022 të dhënat zyrtare mbi popullsinë tregojnë se në grupmoshën 15-29 vjeç pati tkurrje me 27 707 persona vetëm në një vit.

Ligji për Paga do të hyjë në fuqi në tremujorin e parë të 2023-s

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjes, Visar Korenica, ka thënë se për Ligjin për Paga është punuar gjatë në mënyrë që çështja e rrogave për zyrtarët shtetërorë të jetë e rregulluar. Ai vlerëson se ka qenë përkushtim i ministrit të Brendshëm, Xhelal Sveçla dhe tërë qeverisë që ky ligj të përgatitej. Korenica në emisionin e ekonomisë, "Portofol", në "Klan Kosova FM", ka

theksuar se shpejt pritet edhe miratimi përfundimtar dhe hyrja në fuqi. "Ky ligj do të hyjë në fuqi në pjesën e parë të vitit 2023, në tremujorin e parë dhe do të ndikojë pozitivisht. Me rritjen e pagave në sektorin publik do të plotësohet hapësira e krijuar si pasojë e inflacionit", është shprehur Korenica. Lidhur me vlerën e koeficienteve, ai ka nënvizuar se caktohet në bazë të buxhetit vjetor. "Sigurisht që

do të ketë rritje të pagave. Koeficienti, sa kam informacion, do të jetë 120 euro dhe mund të ketë ndonjë lëvizje të vogël. Ka qenë padrejtësi e madhe pabarazia me paga. Me këtë ligj kjo pabarazi është eliminuar dhe është sjell në më pak se pesë shkallë", ka theksuar ai.

Edhe lidhur me Ligjin për Zyrtarët Publikë, Korenica ka theksuar se synohet të silltet barabarësi në mundësi.



Lufta e UÇK-së dhe NATO-s, ndërmarrje e përbashkët çlirimtare



Dr. Albulenë HALILI

(tri teza)

1. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një ndërmarrje çlirimtare

Në studimet bashkëkohore strategjike gjithnjë e më tepër po zënë vend teori të reja të cilat ofrojnë një kuadër të ri që synon t'i analizojë marrëdhëniet themelore të luftës me politikën në përputhje me traditën e Klauzevicit, sipas të cilit, "Lufta është vazhdim i politikës me mjete të dhunës". [1] Të rimenduarit e marrëdhënies themelore të luftës me politikën dhe përshtatja me teorinë klasike të Klauzevicit mbi logjikën politike të luftës, përbëjnë qasjet më të reja teorike në fushën e këtyre studimeve dhe jo vetëm.

Duke u nisur nga ky kuadër teorik modern, padyshim edhe nga dijet tona, vijmë në përfundim se çdo studim mbi luftën çlirimtare shqiptare të fundshekullit të kaluar, pra luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet të fillojë me studimin e logjikës politike të luftës, të cilën e gjejmë te studimi i pararendës legjitime të saj – Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Kësisoj, filozofia politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mund të përkufizohet si vijon – çlirimi nga sundimi serb, irredentizmi përmes republikanizimit të Kosovës dhe bashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë, Shqipërinë, si qëllim i fundmë, i mishëruar në betimin e luftëtarit të UÇK-së, ku artikulohej arsyeja përse ai/ajo do të flijonte gjënë më të shtrenjtë e më të shenjtë – jetën.

Në përkufizimin e mësipërm do të veçoja për ta zbrëthyer konceptin e çlirimit që është edhe objekt i tezës së parë të kësaj kumtese.

Konceptualizimi i çlirimit rri i dyzuar midis individit dhe kolektivës dhe pandashëm me përkufizimin e lirisë si një premisë universale, nga njëra anë dhe shtypjes nga tjetri si mohim i kësaj

lirie, nga ana tjetër. Filozofia e çlirimit mbështetet mbi të drejtën natyrore të individit dhe grupit të cilit ai i përket, për të qenë i lirë nga çdo zgjedhë. Premisa e parë e UÇK-së ishte çlirimi i tokave shqiptare nga pushtimi dhe sundimi serb.

2. UÇK-NATO ishin në një aleancë të heshtur për çlirimin e Kosovës

Në vitin 1999, kur fushata bombarduese e NATO-s po vijonte, një zyrtar i lartë perëndimor pati deklaruar se "NATO nuk do të kthehej në një forcë ajrore të UÇK-së". [2] Por si për ironi të këtij qëndrimi, kjo ndodhi. Shumë shpejt u vërtetua se në rastin e Kosovës një luftë ajrore pa atë tokësore nuk mund të siguronte një fitore. Edhe nëse do të arrihej një e tillë, në rastin më të mirë, do të ishte një fitore e Pirros. Serbët kishin vënë në zbatim operacionin "Patkoi", një projekt të hollësishëm me synim gjenocidal, që u bë publik në prill në vitin 1999, i cili vijonte ta bënte spastrimin etnik në terren pavarësisht prej sulmeve ajrore të NATO-s, madje me intensitet të lartë e të përshtetshëm.

Kështu, konsensusi i brishtë atlantik filloi të forcohej. Konferenca e Rambujesë dhe roli i Rugovës në të e përforcoi edhe më shumë këtë bindje. Aleatët transatlantikë ishin bindur tashmë se UÇK-ja dhe ajo çfarë përfaqësonte kjo ushtri përbënte forcën dominuese në terren dhe me përkrahjen më të gjerë popullore, ndaj ishte e domosdoshme të bashkëpunohet me të. [3] Për më tepër, gjatë fushatës së bombardimeve fati i popullsisë së mbetur civile ishte i lidhur me atë të UÇK-së. Kështu, ata vendosën për të kontribuar në një riorganizim, riorientim dhe ristrukturim të UÇK-së i cili do të ndodhte padyshim me ndihmën e kuadrove ushtarake të Shqipërisë. Pas kësaj kthese lufta për çlirimin e Kosovës u shndërrua në një ndërmarrje të përbashkët çlirimtare

UÇK-NATO. Roli i luftëtarëve të UÇK-së në përcaktimin e shënjestrave të bombardimeve ka qenë shumë i rëndësishëm. Por, roli i tyre kryesor ka qenë detyrimi i njësiteve të ushtrisë jugosllave të dilnin në terren të hapur. Këtë e kishte pohuar pas mbarimit të luftës gjenerali amerikan Short, duke thënë se edhe pse NATO nuk ishte aleate zyrtare me UÇK-në, operimi i saj i suksesshëm në terren kishte ndihmuar aeroplanët gjuajtës të mësojnë pozicionet e ushtrisë jugosllave duke mundësuar asgjësimin e tyre. [4] Një nga studiuesit e njohur të marrëdhënies transatlantike, Stanley Sloan, lidhur me këtë shkruan: "Ringjallja ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si forca kryesore luftarake e shqiptarëve të Kosovës, luajti një rol vendimtar në shpërfaqjen e njësiteve serbe nga fshehja, duke i bërë ato më të ndjeshme ndaj sulmeve ajrore perëndimore. NATO, në fund, kishte një komponentë të forcës tokësore në strategjinë e saj, edhe nëse ajo u zhvillua në heshtje dhe me gjysmë zemër". [5] Gjatë kulmit të fushatës ajrore të NATO-s u shqua sidomos një bashkëpunim i madh midis grupeve të njësiteve të UÇK-së dhe forcave speciale britanike të cilat, në bashkëpunim me gjeneralët amerikanë që drejtuan fushatën bombarduese, janë meritoret e çlirimit të Kosovës. Ndaj me të drejtë historiani i njohur i Ballkanit, James Pettifer, shkruan: "UÇK-ja ishte gjithçka që NATO kishte". [6]

3. Intervenimi i NATO-s në Kosovë qe një test për të ardhmen e saj

Krerët e lartë të diplomacisë së ShBA-së dhe shteteve evropiane vendosën, më në fund, që përmes mekanizmit të NATO-s ta ndalonin gjenocidin serb mbi popullin shqiptar në Kosovë. Kjo nënkuptonte që Kosova në vitin 1999 kishte kaluar në instancat më të larta të sigurisë botërore. Për Kosovën ky ishte fillimi i

zgjdhjes së një procesi 100-vjeçar. Për herë të parë gjatë historisë pesëdhjetëvjeçare të aleancës mbrojtëse NATO përdori forcën e saj ushtarake në një hapësirë jashtë territorit të saj dhe mbi një subjekt ndërkombëtar. Me këtë NATO doli nga doktrina tradicionale e saj si aleancë e cila ishte e përcaktuar të vepronte vetëm në rast sulmi dhe brenda kufijve të saj.

Në rast mosintervenimi në një krizë brenda orbitës së saj, NATO do ta vinte në pikëpyetje vetë ekzistencën e saj si një aleancë e mbrojtjes së paqes dhe demokracisë. Këtë e kishte pohuar dhe senatori Durbin në një seancë dëgjimore në Senatën amerikanë në vitin 1999: "Unë besoj se NATO ka një të ardhme. Unë sigurisht besoj se Amerika ka një të ardhme në udhëheqjen e saj në botë. Ne jemi duke u testuar në Ballkan. Unë dua ta kaloj atë provë kështu që shekulli XXI të jetë një shekull i paqes". [7] Pesëdhjetëvjetori i aleancës transatlantike qe një nga çastet më kulminante të historisë së saj të pas Luftës së Ftohtë. I gjithë Samiti i Uashingtonit, ku edhe u rishqyrtua koncepti strategjik dhe drejtimi i saj në mijëvjeçarin e ri, u përshkua nga zhvillimet në hapësirën ajrore ballkanike, për t'i dhënë fund gjenocidit serb mbi popullatën shqiptare të Kosovës. Koncepti i ri strategjik, i cili u miratua gjatë këtij samiti, i cili u mbajt një muaj pas fushatës ajrore të NATO-s kundër Serbisë, përmbante udhëzimet për përgatitjen e aleancës për sfidat e sigurisë, por edhe për mundësitë e shekullit XXI.

Në këndvështrimin global, ndihma e NATO-s për zgjidhjen e krizës në Kosovë luajti rol vendimtar për kthimin e besueshmërisë në këtë organizatë të krijuar për ruajtjen e sigurisë euro-atlantike dhe justifikimin e qëllimit të krijimit dhe ekzistencës së saj. Ndërkaq, parë nën thjerrëzën shqiptare, NATO përmes një aleance të heshtur i ndihmoi

UÇK-së për ta përmbushur premisën e parë të filozofisë politike të kësaj ushtrie të hedhur në fillim të kësaj kumtese – atë të çlirimit, duke i hapur rrugë edhe përmbushjes së premisë së dytë, krijimit të një shteti të pavarur të Kosovës, gjë e cila, siç e dimë, u bë më 17 shkurt 2008, kur Kuvendi i Kosovës e shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

[1] Carl Von Clausewitz, On War, Princeton UP, 1976, f. 69.

[2] "KLA asks for air strikes to assist guerrilla ground offensive" The Irish Times, 27 prill 1999.

[3] James Pettifer, Ushtria Çlirimtare e Kosovës: nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001, Onufri, Tiranë, 2013, f. 252-253.

[4] William Drozdiak, Allies Need Upgrade, General Says, Washington Post, 20 qershor 1999.

[5] Stanley Sloan, Permanent Alliance?: NATO and the Transatlantic Bargain from Truman to Obama, Continuum, 2010, f. 161.

[6] James Pettifer, Ushtria Çlirimtare e Kosovës..., f. 255.

[7] "Deployment of United States Armed Forces to The Kosovo Region In Yugoslavia", Congressional Record Volume 145, Number 62 (Monday, May 3, 1999), Senate, from the Congressional Record Online through the Government Publishing Office, ff. S4548-S4570.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina e fiton Superkupën, finalja u përshkrua me incidente të rënda

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Sigal Prishtina e ka fituar trofeun e Superkupës së Kosovës. Skuadra kryeqytetase shënoi fitore bindëse në finalen ndaj Trepçës. Ndeshja e zhvilluar në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve përfundoi me rezultatin 73:54. Më meritoret

në triumfin e Prishtinës ishin Derrick Wilson me 18 pikë dhe Dustin Thomas me 16 sosh. Te Trepça u dallua Drilon Hajrizi me 12 pikë. Vlen të theksohet se kjo ndeshje u përshkrua me tensione në tribuna, ku të pranishëm ishin "Plisat" dhe

"Torcidat". Një përplasje e madhe mes tyre ndodhi pasi përfundoi pjesa e parë, me ç'rast u nevojiti edhe ndërhyrja e policisë. Zyrtarët e ndeshjes pastaj vendosën për zbrazje të palestrës dhe pjesa e dytë e ndeshjes u zhvillua pa praninë e tyre.



Çeku: Lëndimi i policëve në një ndeshje basketbolli është veprim i turpshëm

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka reaguar ashpër për atë se çka ndodhi në ndeshjen midis Prishtinës dhe Trepçës në finalen e Superkupës. Çeku theksoi se lëndimi i policëve në një ndeshje basketbolli është veprim i turpshëm, i papranueshëm dhe i dënueshëm. I pari i Sportit theksoi se grupet e tifozëve, në emër të mbështetjes së klubeve të tyre të zemrës, janë duke e shkatërruar shpirtin sportiv. "Në një periudhë aspak të lehtë për shtetin tonë për shkak të zhvillimeve në veriun e Kosovës, lëndimi i policëve në një ndeshje basketbolli është veprim i turpshëm, i papranueshëm dhe i



dënueshëm", ka shkruar Çeku. "Sporti nuk është luftë. Palestrat dhe fushat e sportit nuk janë për "trimat" që kanë problem me vetëpërmbytjen. Për fajin e disave, jemi duke pësuar të gjithë,

është duke pësuar sporti i Kosovës. Grupet e tifozëve, në emër të mbështetjes së klubeve të tyre të zemrës, janë duke e shkatërruar shpirtin sportiv dhe duke i shndërruar palestrat dhe

fushat e sportit në ambiente të pasigurta për qytetarët sportdashës", shtoi ai. "Ndeshjet e sportit janë momente argëtimi për familjet tona, për të gjitha grupmoshat pa dallim. Huliganizmi i disave është shndërruar në tmerrin e prindërve që duan të shijojnë sportin bashkë me fëmijët e tyre". Ai shtoi se prokuroritë dhe gjykatat e Kosovës duhet të jenë më efektive në dhënien e dënimeve për huliganët. "Këshilli për parandalimin e dhunës në kuadër të Ministrisë së Sportit rregullisht ka trajtuar rastet e dhunës në sport, duke i proceduar ato në institucionet relevante. Prokuroritë dhe

gjykatat e Kosovës duhet të jenë më efektive në dhënien e dënimeve për huliganët". "Edhe federatat e sportit duhet të vazhdojnë me veprime dhe vendime të ashpra, pa asnjë kompromis ndaj dhunës. Ministria e Sportit, paralelisht me veprimet e tjera, do të jetë e detyruar të zbatojë edhe veprime radikale për prezencën e tifozëve në palestra dhe fusha të sportit". "Këshilli për parandalimin e dhunës në sport do të mblidhet nesër në mëngjes për të trajtuar dhunën e shfaqur në ndeshjen e sontme të basketbollit mes Prishtinës dhe Trepçës. "Policëve të Kosovës dhe të lënduarve të tjerë u dëshiroj shërim të shpejtë".

Ballkani dhe Prishtina ndajnë pikët



SUHAREKË, 11 DHJETOR - Derbi i Superligës së Kosovës ndërmjet Ballkanit dhe Prishtinës është mbyllur pa fitues, me rezultatin 1:1. Pjesa e parë është karakterizuar me një lojë të qetë nga të dy skuadrat. Ishte kampioni në fuqi që në rastin e parë drejt portës ka realizuar gol. Në minutën e 11-të ka shënuar

Edvin Kuç pas një gjuajte të bukur, duke i dhënë epërsinë suharekasve. Kryeqytetasit në anën tjetër janë munduar ta barazojnë rezultatin, por nuk ia kanë arritur. Pjesa e parë është mbyllur 1:0 në favor të Ballkanit. Edhe në 45 minutat e dytë ekipi i Ilir Dajës ishte ai që kërkonte më shumë golin. Mirëpo, edhe

kryeqytetasit janë munduar të barazojnë shifrat, por kanë arritur krejt në fund të realizojnë gol. Ishte Kreshnik Uka që nga pika e bardhë është treguar i saktë. Me këtë barazim, Ballkani qëndron në vendin e dytë me 38 pikë, kurse Prishtina pozicionohet në vendin e tretë me 27 sosh.

KH Besa eliminohet nga garat evropiane

PEJË, 11 DHJETOR - Një ndeshje e fortë evropiane është luajtur të dielën mbrëma në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Para një numri të konsiderueshëm shikuesish, kampionia e Kosovës në hendboll, Besa Famgas është përballur me skuadrën kroate, Sesevete. Ndeshja ishte interesante dhe shumë e luftuar nga të dy skuadrat. Por në fund, me gol në sekondën e fundit, ka fituar Sesevete. Kështu Sesevete

avancoi tutje, ndërsa Besa Famgas ndalet në raundin e tretë të Kupës Evropiane. 28:27 në të mirë të Sesevetes ishte rezultati në fund. Skuadra kroate ka fituar edhe ndeshjen e parë, të luajtur një javë më herët në Zagreb. Besa në raundin e dytë e kaloi Helsinkin e Finlandës. Në ndeshjen e së dielës me Seseveten më efikas ishte Victor Alonso. Ai realizoi 7 gola nga dhjetë tentime. Gjashtë gola nga shtatë tentime

i kishte Egzon Gjuka. Nikola Prcë shënoi katër gola nga tetë tentime. Te skuadra kroate Sesevete, më efikas ishte Patrik Hrshak me 7 gola nga 11 tentime. Davor Gavriq i kishte 6 gola nga 9 tentime. Portieri Filip Periq u dallua me dhjetë pritje. Besa tani i kthehet sfidave vendore, kurse të kjo skuadër gradualisht po rritet një gjeneratë e re lojtarësh që premtonte shumë për të ardhmen.





Shqiptarë Humanitare Bëmërisë e Kosovës "Nina Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarëme Dobritëme Ushqesje Kosova "Mëke Teresa"
38400 Prishtinë, Rr. Agim Ramadani pm. Tel:06051 38 542 864. Fax: 5423865.
Web site: www.ninateresa.org e_mail:ninateresa@yahoo.com

CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 12/12/2022

Procurement No	Training	002	2022	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone: 038-542-865
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-869
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Training for 200 Women beneficiaries & Capacity Building for 6 BMO-s
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)
<input type="checkbox"/> Works <input type="checkbox"/> Supplies <input checked="" type="checkbox"/> Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Training for 200 Women beneficiaries & Capacity Building for 6 BMO-s
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000-8
II.1.7) Variants are accepted No <input type="checkbox"/> Yes <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.8) Division into lots Yes <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/>
Lot 1 Training for 200 Women Beneficiaries Lot 2 Capacity Building for 6 BMO-s
II.1.11) Estimated contract value: Lot 1 40,000.00 Euro approximately and Lot 2 18,000.00 Euro approximately

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 3 month (from the contract signature)
or
Starting Lot 1 09.01.2023 Start Lot 2 09.02.2023 Start
20.02.2023 Finish 20.03.2023 Finish
Completion 31/03/2022

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required No <input type="checkbox"/> Yes <input checked="" type="checkbox"/>
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject No <input type="checkbox"/> Yes <input checked="" type="checkbox"/>

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable <i>Documentary evidence required</i> Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. Business Registration Certificate 2. List of proposed experts and administrative staff and their CV-s 3. References of previous experience in similar projects <i>Documentary evidence required:</i> Copy of prove documents
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo 2. Court Certificate only for Winner 3. Company profile <i>Documentary evidence required:</i> Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity 1. Business License Certificate <i>Documentary evidence required:</i> Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession No <input type="checkbox"/> Yes <input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service Yes <input checked="" type="checkbox"/>

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure
<input checked="" type="checkbox"/> Open

IV.2) AWARD CRITERIA

LOWEST PRICE

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 16/12/2022	
Payable documents	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Additional information Date 23/12/2022 time 14:00 place Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders <input checked="" type="checkbox"/> no	
IV.3.5) Is tender security needed:	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.6) Tender validity period: date: 28/12/2022 days 30 or months 1	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 28/12/2022 time 14:30 place Prishtina	

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Newco Agromorava L.L.C. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me nr. Unik Identifikues 810510835 bënë shpalle në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 216,750.00€ në zero euro (0).

- Arta Sheqeri B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810900771.

Kujtim Kyqyku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

Behim Alimi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Mihrem Bajra shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Floridan Begaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

Myrvete Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën nga klasa 1-8 te shkollës fillore Musa Hoti (Ish Meto Bajraktari).

D.P.H " Break Time Caffè" shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70916479.

Albina Hoxhaj shpalle te pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLM " De Xheladin Deda".

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

